



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 331 Prot.

Tiranë, më datë 09.08.2024

**VENDIM**

**Nr. 289, datë 09.08.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.08.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Rindërtim objekt banimi 1 kat (pa ndryshim funksioni), banesa e z. Zyber Kulla, Zona Kadastrale 1771, Nr. Pasurie 245, Gjuricaj, Durrës”, në afërsi të Pasurisë Kulturore “Bazilika e Gjuricaj”, me aplikues dhe zhvillues z. **Zyber Kulla, me rekomandimin;**
  - Objekti i banimit 1 kat (pa ndryshim funksioni), të rindërtohet mbi themelet ekzistues;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë monitorimin arkeologjik të punimeve në kuadër të projektit “Rindërtim objekt banimi 1 kat (pa ndryshim funksioni), banesa e z. Zyber Kulla, Zona Kadastrale 1771, Nr. Pasurie 245, Gjuricaj, Durrës”, në afërsi të Pasurisë Kulturore “Bazilika e Gjuricaj”, me aplikues dhe zhvillues z. **Zyber Kulla**, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI

KRYETAR  
Blendi GONXHJA